



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor të datës 19.01.2006 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____ 2022 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

**MBI CAKTIMIN E TARIFAVE PËR QËNDRIMIN DITOR TË FËMIJËVE NË
INSTITUCIONET PARASHKOLLORE NË FSHATRA T GADIME DHE SLLLOVI**

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen obligimet e prindërve për pagesën e tarifave, procedura për lirim nga pagesa e këtyre tarifave , zvogëlimet e tarifave dhe aplikimi i tarifave për qëndrim ditor të fëmijëve në dy Institucionet parashkollore njëra në fshatin Slllovi dhe tjetra në fshatin Gadime .

Neni 2

Kompenzimi për qëndrim ditor

Prindërit, përkatësisht kujdestarët, për vendosjen e fëmijëve për qëndrim ditor në Institucionet parashkollore në Gadime dhe Sllovi, në emër të participimit për një fëmijë, për çdo muaj duhet të paguajnë shumën prej 30.00 €.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e tarifave

Lirimi nga pagesat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi do të bëhet në pajtim me dispozitat ligjore .

Neni 4

Zvogëlimi i tarifave

Prindërit përkatësisht kujdestarët e fëmijëve do të paguajnë tarifën e zvogëluar për qëndrimin ditor për më shumë se një fëmijë, s'i vijon:

Për fëmijën e dytë shumën prej 21.00 €.

Për fëmijën e tretë shumën prej 15.00 €.

Neni 5

Aplikimi i Tarifave

Aplikimi i tarifave do të fillojë pas përfundimit të fazës provuese pasi dy institucionet parashkollore të cekura më lartë janë në fazën provuese të funksionalizimit të tyre përkatësisht fillojnë të aplikohen nga data 01.01.2023 dhe vlejnë deri me datën 31.12.2023 .

Neni 6

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen e Komunës.

A r s y e t i m i

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim -vendimi është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor të datës 19.01.2006 , Udhëzimit Administrativ nr. 41/2007 - Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet

parashkollore dhe nenit 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Me dispozitat e nenit 24 te Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi Edukimin Parashkollor parashihet: "Tarifat që duhet të paguhet nga prindërit do të përcaktohen nga Komuna në bazë të një shkalle që grupon prindërit në të ardhurat për pjesëtarë të familjes në krahasim me pagën mesatare në Kosovë dhe pasurisë familjare"

Propozimi i tarifave me shumat e propozuara më lartë bëhet kryesisht me qëllim të përkrahjes dhe nxitjes së punësimit të nënave në viset rurale pasi këto dy institucione gjenden në dy fshatra të Komunës së Lipjanit dhe supozohet se mund të ndikojë edhe në ndalimin e shpërnguljes së banorëve nga fshatrat në qytet.

Duke u bazuar ne dispozitën e sipër cituar propozojmë miratimin e këtij Vendimi.

1Nr. 011/01-48382
Lipjan, më 07.09.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

